



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 dhjetor 2011
Nr. ref.: RK164/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 39/10

Parashtruesi

Bujar Luzha

kundër

**Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit të
Kuvendit Komunal të Kaçanikut**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almira Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Bujar Luzha me vendbanim në Kaçanik.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimin 06 nr. 6924/2009 të 26 gushtit 2009 të Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Objekti i çështjes

3. Kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me shkelje të supozuar të nenit 46 paragrafi 1 dhe 2 [Mbrojtja e Pronës], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tutje: "Kushtetuta").

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit dhe Rregulli 56(2) i Rregullores.

Procedura në gjykatë

5. Më 31 maj 2010, parashtruesi i kërkesës dorëzoi Kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tutje: "Gjykata").
6. Më 2 qershor 2010, me Vendimin Nr. GJR. 39/11 Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar Raportues dhe po të njëjtën ditë me vendimin Nr. KSH. 39/10 caktoi Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Robert Carolan (kryesues), 2. Mr. sc. Kadri Kryeziu dhe 3. Dr. Iliriana Islami.
7. Më 24 gusht 2010, kopja e kërkesës së parashtruesit iu dërgua Kuvendit Komunal në Kaçanik (më tutje: "KK-Kaçanik"), respektivisht Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit (më tutje: "DUKMM").
8. Më 4 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentacion shtesë.
9. Më 6 qershor 2011, Kuvendi Komunal i Kaçanikut dorëzoi përgjigje në kërkesë.
10. Më 22 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të procedurave administrative

11. Më 7 korrik 2009, KK-Kaçanik, me Njoftimin nr. 06. nr. 5146/2009, kërkoi nga parashtruesi që deri më 7 gusht 2009 ta lirojë lokacionin që ia kishte dhënë me qira KK-Kaçanik, respektivisht DUKMM-ja.
12. Më 27 korrik 2009, parashtruesi paraqiti ankesë në KK-Kaçanik dhe kundërshtoi njoftimin nr. 06. nr. 5146/2009 për lirimin e lokacionit që ia kishte dhënë më vendimin 05. nr 463-70/86 të 8 korrikut 1987 ish KK-Kaçanik.
13. Më 3 gusht 2009, KK-Kaçanik respektivisht DUKMM-ja me aktvendimin Nr. 6035/2009 refuzoi kërkesën e parashtruesit dhe vendosi që edhe më tutje të mbetet në fuqi njoftimi nr. 06. nr. 5146/2009 i 7 korrikut 2009, me arsyetimin se në lokacionin ku gjendeshin lokalet e përkohshme afariste ishte planifikuar ndërtimi i hyrjes kryesore nga magjistralja M2 për qytetin e Kaçanikut, dhe se parashtruesi është shfrytëzues i përkohshëm në bazë të vendimit 05. nr 463-70/86 të 8 korrikut 1987.

14. Me 7 gusht 2009, në afatin e paraparë ligjor, parashtruesi bëri ankesë në Ministrinë e Planifikimit Hapësinore (më tutje: "MPH"-ja) kundër Aktvendimit Nr. 6035/2009 të 3 gushtit 2009 të KK-Kaçanik. Parashtruesi në ankesë ceku se lokacioni për të cilin bëhet fjalë nuk është nën pronësinë e KK-Kaçanik, por është pronë e Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit, respektivisht Drejtorisë së Rrugëve.
15. Më 26 gusht 2009, DUKMM-ja me aktvendimin Nr. 6924/2009 refuzoi serish ankesën e parashtruesit dhe me tutje la në fuqi njoftimin 06. nr. 5146/2009 të 7 korrikut 2009 dhe aktvendimin Nr. 6035/2009 të 3 gushtit 2009 për largimin e pronës së përkohshme, duke potencuar se objekti i përkohshëm i cili i është lejuar parashtruesit për shfrytëzim në vitin 1987 është i vendosur në pjesën e ngastrës kadastrale, e njohur si Rrugët Publike të pa kategorizuara, me të cilat menaxhon Komuna e Kaçanikut.
16. Më 5 tetor 2009, parashtruesi kërkoi që KK-Kaçanik t'ia dorëzojë procesin lidhur me ekzekutimin e rrënimit të objektit me dhunë nga kjo e fundit.
17. Më 6 qershor 2011, Komuna Kaçanikut dorëzoi përgjigjen në kërkesë me anë të së cilës mbron ekzekutimin e vendimit të saj për rrënimin e objektit të parashtruesit, duke e arsyetuar atë me faktin që parashtruesi ka qenë i njoftuar në kohë për largimin e objektit të tij. E njëjta pretendon që parashtruesi është ankuar dhe është thirrur Po ashtu thekson se aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për dhënien e masës së sigurisë ka të bëjë me ngastrën kadastrale 1849 e jo me ngastrën kadastrale 1850 të evidencuar në listën poseduese nr. 1159 si pasuri shoqërore – Rrugë të pakategorizuara, shfrytëzues Komuna e Kaçanikut.

Përmbledhja e fakteve të procedurave gjyqësore

18. Më 22 korrik 2009, parashtruesi ushtroi në Gjykatën Komunale të Kaçanikut padi me nr. C.nr.133/2009, përmes së cilës kërkoi caktimin e masës së sigurisë dhe vërtetimin e pronësisë, por kjo e fundit nuk aprovoi kërkesën e parashtruesit për dhënien e masës së sigurisë.
19. Më 7 gusht 2009, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kundër aktvendimit nr. C.nr.133/2009 të 22 korrikut 2009, dhe kërkoi aprovimin e kërkesës për masë të sigurisë.
20. Më 22 shtator 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori aktvendimin Ac.nr 923/2009 dhe miratoi kërkesën e parashtruesit për masë të sigurisë, më ç'rast e ndaloi të paditurën, Drejtorinë e Rrugëve në Prishtinë, dhe personat e tretë në ndërmarrjen e çfarëdo veprimi që do të dëmtonte objektin e ndërtuar të vendosur në pjesën e ngastrës kadastrale 1849 në vendin e quajtur "Dushkaja", me kulturë rrugë e rendit të parë e regjistruar në fletëposedimin nr. 1159 ZK, përderisa çështja e rrënimit dhe rrëzimit të objektit të zgjidhet në procedurë administrative.
21. Më 29 shtator 2009, edhe përkundër faktit që Gjykata e Qarkut në Prishtinë miratoi kërkesën e parashtruesit për aplikimin e masës së sigurisë, KK-Kaçanik nuk zbatoi vendimin e gjykatës për ndalimin e rrënimit të objektit. Por në mënyrë të dhunshme urdhëroi rrënimin e tij, edhe pse aty ishte i vendosur vendimi Ac.nr 923/2009 për pezullimin e të gjitha veprimeve lidhur me objektin.
22. Më 15 janar 2010, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (më tutje: IAP). Ky institucion ekzekutimin e Aktvendimit Nr. 5156/09 të 29 shtatorit 2009 e konsideroi si jo kushtetues, përderisa KK-Kaçanik, respektivisht DUKMM-ja, u njoftua që Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka miratuar kërkesën e parashtruesit për dhënien e masës së sigurisë, prandaj veprimi i ndërmarrë nga

autoritetet Komunale të Kaçanikut është në kundërshtim me nenin 124 paragrafi 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. IAP ka kërkuar nga KK-Kaçanik informacione lidhur me arsyen e mos zbatimit të masës së sigurisë lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 22 shtator 2009, në një afat të arsyeshëm jo më vonë se 26 shkurti 2010, për të proceduar më tutje me kërkesën e parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se autoritetet Komunale të Kaçanikut me Aktvendimin 06 nr. 6924/2009 të 26 gushtit 2009, kanë vendosur në mënyrë kundërligjore për shkak se organi që ka nxjerrë vendimin, sipas parashtruesit ka qenë jo kompetent dhe ka vendosur përkundër faktit që Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka miratuar kërkesën e tij për aplikimin e masës së sigurisë, këto shkelje janë konstatuar edhe nga IAP, siç përmendet në paragrafin 18 të këtij raporti.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Parashtruesi pretendon se e drejta e tij e garantuar me Nenin 46 paragrafi 1 dhe 2 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës i është shkelur. Gjykata, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për Kërkesën e parashtruesit duhet që fillimisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës, posaçërisht, duhet të provojë nëse i ka shterur të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
25. Gjykata, pasi që shqyrtoi të gjitha faktet dhe provat relevante, vëren se parashtruesi kishte ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Kaçanik dhe kishte kërkuar vërtetimin e pronësisë së pronës kontestuese, si dhe aplikimin e masës së sigurisë për çështjen e njëjtë, mirëpo kërkesëpadia e parashtruesit ishte refuzuar si e pa bazë nga kjo e fundit. Parashtruesi, më pas, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë me kërkesën për aplikimin e masës së sigurisë dhe ndalimin e rrënimit të objektit në ngastrën kadastrale 1849, pasi që kjo e fundit kishte vërtetuar gjendjen reale faktike e konsideron si të arsyeshme dhe të bazuar kërkesën e parashtruesit për aplikimin e masës së sigurisë bazuar në nenin 297.1(b) të LPK-së, nga fakti që Gjykata Komunale kishte bërë vlerësim të gabuar të së drejtës materiale për shkak se Komuna e Kaçanikut nuk ia kishte specifikuar parashtruesit drejt dhe saktë në njoftim se cilat veprime duhet t'i ndërmerre i njëjti për lirim të lokacionit, pasi që bëhej fjalë për dy ngastra kadastrale. Më pas KK-Kaçanik, edhe përkundër faktit që Gjykata e Qarkut në Prishtinë kishte miratuar kërkesën e parashtruesit për aplikimin e masës së sigurisë, ka urdhëruar rrënimin e objektit.
26. Megjithatë, Gjykata konstaton se edhe sikurse të ekzistonin shkeljet e supozuara të të drejtave të garantuara me kushtetutë, parashtruesi i kërkesës është dashur që të drejtën e tij ta realizojë përmes procedurave të rregullta gjyqësore, duke ushtruar padi në gjykatën kompetente, me kërkesë për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga autoritetet e Komunës së Kaçanikut.
27. Prandaj, nga faktet përmendura me lartë, del se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, nga shkak se parashtruesi nuk ka provuar që i ka shterur të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion sipas ligjit, që qartazi citon:

Neni 47.2 [Ligji për Gjykatën Kushtetuese]

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"

28. Arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t'u ofrojnë autoriteteve kompetente, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin, se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike për shkeljet e të drejtave kushtetuese (shih; Aktvendimi për Papranueshmëri: AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë vs Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI-41/09 të datës 21 janar 2010) dhe shih *mutatis mutandis*, ECHR, Selmouni v. France, no. 25 803/94, vendim i 28 korrikut 1999).
29. Rrjedhimisht, Kërkesa e Parashtruesit është e papranueshme bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 22 nëntor 2011, njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Raportues


Altay Suroy



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani